

Të nderuar pjesëmarrës,

Koncepti i transparencës duket të jetë kompleks në etiologjinë e tij dhe në interpretimin e tij autentik.

Në sajë të kësaj, bëhet fiziologjike të vërehet se disiplinat e reja mbi këtë temë përcaktojnë të drejtën e qytetarit për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të administratës publike: por unë dëshiroj ta them sa më thjesht, duhet që administrata publike të bëhet një “*Shtëpi me mure prej xhami*”, e tillë, që çdo gjë brenda të jetë vazhdimisht e dukshme dhe e disponueshme për qytetarin.

Prandaj, aplikimi i transparencës është aq më urgjent, sa më i rrënjosur është fenomeni i korrupsionit.

Në këtë tablo të përgjithshme, ekzistenca e një sistemi parandalimi *ex ante* mund të jetë një gur themeli konkret për përgatitjen e kundërveprimeve të sakta.

Transparenca kuptohet si akses i plotë i të dhënave dhe dokumenteve të mbajtura nga administrata publike, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe promovimin e formave të gjera të kontrollit mbi ndjekjen e funksioneve institucionale dhe përdorimin e burimeve publike.

Transparenca kontribuon në zbatimin e parimeve kushtetuese të barazisë, paanësisë, performancës së mirë, përgjegjësisë, efektivitetit dhe efikasitetit në përdorimin e burimeve.

Kjo integron të drejtën për administrim të mirë dhe kontribuon në krijimin e një administrate që i shërben qytetarit.

James Medison, rreth 200 vjet me parë, ka shkruar: “*Një qeveri publike pa informacion publik, ose që nuk ka nocionin e dhënies së tij, është prologu i një farse apo tragjedie, ose ndoshta të dyja bashkë.*”

Prej vitit 2014 kemi në fuqi një ligj të së drejtës për informim, që konkurren në vendet e para në botë, jemi një nga 15 vendet që kemi pjesë të legjislacionit Konventën 205 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumenta zyrtare”, kemi përafrim gati 100% me kuadrin ligjor të BE përsa i përket të dhënave të hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik, të gjitha këto të miratuara në dy vitet e fundit, si edhe ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Dhe lajmin e fundit, ku përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit është votuar dhe zgjedhur në 10 ekspertët e të drejtës për informim të Këshillit të Evropës. Është sukses për Elonën, për Zyrën e Komisionerit, por mendoj, se edhe me ju zoti Kryeministër apo edhe me Ministren Pirdeni ndajmë opinionin dhe krenarinë që ky vlerësim dhe kjo arritje i përket të gjithë administratës publike shqiptare.

Legjislacioni për të drejtën e informimit dhe veçanërisht instrumenti i Programit të Transparencës, ka pasuruar hapësirën operationale të parimit të transparencës, duke e bërë atë funksional edhe në luftën kundër korrupsionit.

Premisa e këtij nocioni më të gjerë të transparencës është se sjelljet e keqmenaxhimit fshihen në errësirë. Për këtë arsye, objektivi i ligjvënësit është të nxjerrë në dritë të gjithë punën e administratës publike për të shmangur sjelljet e paligjshme dhe korruptive.

Parimi i transparencës bëhet kështu një mjet për të garantuar demokracinë dhe mirëqeverisjen.

Dhe ashtu si administrata jonë publike, tregoi integritet të lartë profesional në procesin *screening*, të njëjtin angazhim vlerësoj se duhet të ketë edhe në raport me transparencën.

Dhe konstatoj, që kemi filluar të ecim në rrugën e duhur.

Në Konferencën VI Kombëtare të së Drejtës për Informim, të bashkëorganizuar me Ministren e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA), 6 muaj më parë, besoj se u ndërmor një hop cilësor, duke hedhur themelet për një transparencë proaktive dhe jo vetëm, të administratës shtetërore.

Zyra e Komisionerit e vlerëson shumë kontributin e Ministres në këtë drejtim.

Konstatojmë sot një përmirësim shumë të ndjeshëm të Programeve të Transparencës së Ministrive dhe për këtë rezultat jemi koordinuar në mënyrë të pandërprerë dhe tepër efektive me MAPA.

Ministritë e kanë të kompletuar Programin e Transparencës me informacione të plota mbi:

- strukturën e autoritetit,
- funksionet që ato ushtrojnë,
- mënyrën e marrjes së vendimeve,
- akte normative të përditësuara, duke publikuar ligjet, Vendimet e Këshillit të Ministrave, udhëzimet dhe urdhrat e ministrave sipas fushave të kompetencës së tyre, si dhe projekt-aktet për konsultim publik,
- rregulloret e brendshme,
- strategjitë kombëtare e ndërinstitutionale,
- të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit,
- buxhetin vjetor aktual dhe të viteve të kaluara,
- raportet vjetore për zbatimin e buxhetit,
- regjistrat e parashikimit të prokurimit publik dhe ato të realizimeve,
- shërbimet që afrohen nga ministritë,
- statistika,
- projekte, etj.

Por, është vetëm fillimi i një rrugëtimi të gjatë, i rrënjosjes së kulturës së transparencës, ku diçka pikërisht së është zyrtare duhet të jetë në dritën e publikut dhe jo e kundërta.

Ne sot mbikëqyrim transparencën e 360 autoriteteve publike (*vetëm me 5 nëpunës*), përfshirë të 3 pushtetet, Kuvendin, Ekzekutivin, Gjyqësorin e Prokurorinë, Organet e Vetëqeverisjes Vendore, Institucionet e Arsimit të Lartë Publik dhe shoqëritë tregtare me kapital publik.

Por, si për shkak të numrit mbi 200, si për shkak të përmbajtjes, intensitetit, peshës specifike, interesave dhe testit të interesit të lartë publik, transparenca e pushtetit ekzekutiv mbetet vendimtare.

Në Konferencën VI Kombëtare diskutuam që rreth 70% e ankesave që vijnë në Zyrën e Komisionerit marrin përgjigje pas ndërhyrjes tonë. Kjo është një rezervë shumë e madhe ku autoritetet publike duhet të përmirësohen.

Do të doja të ndanim një objektiv të rradhës, mund të duket edhe jo me vend, por në mënyrë figurative ju keni në dorë që “Zyrën e Komisionerit ta lini pa punë”, dhe kështu qeveria nuk do të “bezdisej” nga ndërhyrjet dhe oponenca e vazhdueshme e Komisionerit, Ministria e Financave nga kërkesat e vazhdueshme për mbështetje buxhetore dhe punonjës, ndërsa, nga ana tjetër Komisioni Evropian dhe Delegacioni në Tiranë, në çdo Progres Raport nënvizojnë mbështetjen për Zyrën e Komisionerit.

Dhe sinqerisht, faleminderit zoti Ambasador.

Më shumë, për projektet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, ku falë kontributit të Bashkimit Evropian është hartuar projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe që shpresoj, se do të miratohet nga Kuvendi javën që vjen, sipas kalendarit të tij të punimeve dhe Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE).

Ndoshta duhet të eksplorojmë edhe Transparencën.

Në Konferencën VI Kombëtare ne prezantuam një projekt për *e-transparencën* e pushtetit vendor, një sistem që përdor indikatorë të qartë të performancës dhe raporte të rregullta për progresin e tyre, përfshirë edhe të dhëna lidhur me buxhetin e bashkive, të ardhurat, shpenzimet, projektet e zhvillimit, etj, ku jo Programi i Transparencës të jetë pjesë e vlerësimit të performancës së tyre, por performanca e tyre të matet nëpërmjet instrumentit ligjor të Programit të Transparencës.

Vitin 2025 Komisioneri ka detyrimin ligjor të rishikojë Programin Model të Transparencës.

E kemi objektiv, por ndoshta nuk do të mund të realizohet për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme për vitin e ardhshëm edhe pse modeste.

Gjithashtu, ne kemi ideuar dhe realizuar me fonde të donatorëve edhe funksionimin e portalit *pyetshtetin* prej gati 9 viteve.

Në të gjendet një informacion për të gjitha autoritetet publike sipas kategorive, koordinatorët dhe së bashku me “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe pergjigjeve” mund të integrohen shumë mirë edhe me inisiativën *Transparent Albania*.

Që të vazhdojmë trajektoren pozitive, duhet:

- ✓ forcimi i infrastrukturës digjitale, që transparenca të jetë e aksesueshme për të gjithë qytetarët;
- ✓ promovimi i pjesëmarrjes publike, sigurimi i mjeteve dhe platformave për qytetarët që të angazhohen në mënyrë aktive;
- ✓ sigurimi i cilësisë dhe qartësisë së të dhënave, që të jenë të kuptueshme për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga prejardhja ose ekspertiza e tyre;
- ✓ nxitja e llogaridhënies në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Transparenca proaktive nuk ka të bëjë vetëm me vënien në dispozicion të informacionit – **ka të bëjë me nxitjen e një mjedisi ku hapja dhe llogaridhënia janë normë, jo përjashtim.**

Së fundi, në praktikën evropiane është e pakonceptueshme që një autoritet publik të mos zbatojë një opinion apo rekomandim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Marrëdhënia e Institucioneve Kombëtarë të të Drejtave të Njeriut me autoritetet publike dhe e këtyre me qytetarin dhe patjetër me shoqërinë civile, median apo çdo grup interesi, duhet të mbështetet në integritetin dhe në luajalitetin institucional.

Kjo është aksioma jonë.

Ky është objektivi ynë, i përbashkët, në funksion të integritetit të vendit, për Shqipërinë 2030, një transparencë që konkurren praktikën më të mirë të Bashkimit Evropian.

Ju faleminderit.